



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 7 mars 2017

Numri i lëndës: 2015-11

Zvonimir Jovanovic

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 mars 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese

Z. Guénaël METTRAUX, anëtar

Znj. Anna BEDNAREK, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga

Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar me 5 gusht 2015.

II. FAKTET

2. Faktet e lëndës paraqiten nga informatat që ankuesi ka ofruar:
3. Me datën 18 qershor 1999, ankuesi kishte blerë nga Ushtria jugosllave një apartament, ku kishte jetuar për një periudhë kohore të pasaktësuar.
4. Pronësia e ankuesit mbi pronën ishte kontestuar nga një palë e tretë. Si rezultat, ankuesi ka parashtruar një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës dhe me 19 dhjetor 2008, Komisioni për Kërkesa Pronësore (KKPK) ka vodusur çështjen kundër kërkesës së ankuesit dhe ka konstatuar se pronësia e ligjshme i përkiste palës së tretë.
5. Ankuesi ka parashtruar ankesën me kohë kundër këtij vendimi.
6. Me 19 maj 2011, Kolegji i Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës i Gjykatës Supreme të Kosovës në përbërje të një kolegji të përzier të gjykatësve të Kosovës dhe gjykatësve ndërkombëtarë ka refuzuar ankesën.
7. Ankuesi ka deklaruar se tridhjetë (30) ish-banorët e tjerë të ndërtësës kanë të njëjtën dokumentacion të pronësisë ashtu siç e ka ai, dhe në këtë mënyrë e kanë fituar pronësinë e banesës së tyre në bazë të këtyre dokumenteve. Ai pohon se pronësia e tij nuk ishte njojur për shkak se pala e tretë që e ka kontestuar pronësinë e tij të banesës “ishte pjesëtar i UÇK-së dhe gruaja e tij punon në Gjykatën në Ferizaj”.

III. ANKESAT

8. Ankuesi pohon se të drejtat e tij për mbrojtjen e pronës dhe të barazisë para ligjit janë shkelur. Ankesa gjithashtu duket se sugeron se ka pasur anshmëri apo mungesë të paanshmërisë nga ana e gjykatës.
9. Përderisa ankuesi nuk i referohen ndonjë dispozite të veçantë, është e qartë nga natyra e ankesës se dispozitat përkatëse janë nen 6(1) i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”)) dhe nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

IV. LIGJI

10. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen

e të drejtave të njeriut që të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

11. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
12. Sipas Rregullës 25, parografi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e gjiqësisë, policisë dhe doganave.
13. Paneli konstaton se ankesa e ankuesit ka të bëjë ekskluzivisht me procedurat pranë Agjencisë Kosovare të Pronës, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KPKK) dhe Kolegji i Ankesave i Agjencisë Kosovare të Pronës.
14. Paneli ka konstatuar në mënyrë të përsëritur se në bazë të rregullës 25, parografi 1, bazuar në konceptin e llogaridhënieve në OPLAN të EULEX-it Kosovë, nuk mund të shqyrtojë procedurat gjyqësore që janë në gjykatat e Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të gjykatës nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih *ndër të tjera, Fahri Rexhepi kundër EULEX-it*, nr. 2014-19, 10 nëntor 2014, par. 12; *Gani Zeka kundër EULEX-it*, 2013-15, 4 shkurt 2014, par. 13). Prandaj Paneli në parim nuk mund të shqyrtoj vendimet e gjykatësve të EULEX-it si të tilla.
15. Megjithatë Paneli tashmë ka konstatuar se në rrethana të caktuara kompetencat e Panelit mbulojnë vendimet dhe aktet e autoriteteve gjyqësore si të tillë, në veçanti atëherë kur pohimet e besueshme për shkelje të të drejtave të njeriut që i atribuohet gjykatësve të EULEX-it nuk janë adresuar plotësisht nga autoritetet kompetente gjyqësore në procedurën e apelit (shih p.sh., *Milica Radunovic kundër EULEX-it*, nr. 2014-02, 12 nëntor 2015 par 17; *Tomë Krasniqi kundër EULEX-it*, nr. 2014-04, 27 maj 2014, par. 15).
16. Kjo ankesë ka të bëjë me procedurat pranë gjyqësorit të Kosovës, prandaj në parim bien jashtë juridiksionit të Panelit.
17. Për më tepër, lidhur me pretendimin e ankuesit për anshmëri dhe/ose mungesë të paanshmërisë, ankesi ka dështuar të ngritë këtë çështje pranë gjykatave dhe kështu nuk iu ka mundësuar gjykatave ta adresojnë pretendimin e tij. Prandaj gjykata nuk mund të thuhet se ka dështuar të merrej me këtë çështje. Kështu Paneli nuk mund të thirret në juridiksionin e tij të mbetur siç pëershkrumë më lartë në paragrafin 15.
18. Nga kjo del se ankesa nuk hyn në kuadër të mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese